Në bazë të nenit 125, 131 dhe 135 të Ligjit për arsimin e lartë (“Gazeta zyrtare e RepublikëssëMaqedonisë” numër35/08,103/08, 26/09, 83/09, 99/09,115/10, 17/10, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14,10/15,20/15,98/15,145/15,154/15, 30/16, 120/16 и 127/16) dhe Rregullores për kriteriumet dhe procedurën për përzgjedhje në thirje mësimoro – shkencore dhe bashkëpunëtorë – asistent doktorant në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Këshilli i rektoratit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, shpall:

**KONKURS**
**Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirjet mësimoro – shkencore të Fakulteteve pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**

Shpallet Konkurs për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirjet mësimore – shkencore në kohë të pacaktuar në:

**A.Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës** pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

**A.1 Programi studimor: ARKITEKTURË DHE DIZAJN**

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM URBAN DHE HAPËSINOR (20114), ARKITEKTURA E PEJSAZHIT (20116)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**A.2 Programi studimor: NDËRTIMTARI - KONSTRUKTIVE**

1. Zgjedhje të një asistent – doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **KONSTRUKSION NDËRTIMOR NË NDËRTIMIN E ULËT DHE TË LARTË (20702), KONSTRUKSIONE ARKITEKTONIKE** (20112) nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**B.Fakulteti i shkencave informatike** pranëUniversitetit “Nënë Tereza” në Shkup

**B.1**Programistudimor: **INFORMATIKË - PROGRAMIM**

1. Zgjedhje të një asistent doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET DHE INTELEGJENCA ARTIFICIALE (21205)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**C.Fakulteti i shkencave teknike** pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

**C.1**Programistudimor: **SISTEMET ELEKTROENERGJETIKE**

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **FIZIKË (10300)** ngaKlasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**C.2** Programi studimor: **MEKATRONIKË**

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi nga fusha arsimore – shkencore **PROCESIMI I TË DHËNAVE (21206), ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA E PROEKTIMEVE TË SISTEMEVE LLOGARITËSE (21207)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**C.3** Programi studimor: **EKONOMIA E APLIKUAR DHE NDËRMARRËSI**

1.Zgjedhje të një mësimdhënësi nga fusha arsimore–shkencore **ANGLISTIKË (64004)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**Ç.Fakulteti i shkencave sociale** pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

**Ç.1** Programi studimor: **POLITIKA SOCIALE DHE PUNA SOCIALE**

1 . Zgjedhje të një asistent doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET E MBROJTJES SOCIALE (51204), PSIKOLOGJIA SOCIALE (51006), PSIKOLOGJIA E PUNËS (51007)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**Ç.2** Progamistudimor: **STUDIME EVROPIANE (NË GJUHË ANGLEZE)**

1 Zgjedhje të një asistent – doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET POLITIKE (50701), E DREJTA KRAHASUESE (50809), TJETËR (50710)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

**Kushtet dhe kriteret për zgjedhje:**

Kandidatët përveç kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet dhe kriteriumet e parapara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Rregulloren për kriteriumet dhe procedurën për zgjedhje në thirje mësimore – shkencore, mësimore, mësimore – profesionale, dhe bashkëpunëtorë – asistent – doktorant në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup.

Kandidatët obligohen të dorëzojnë dokumetet në vijim: fletparaqitje për konkurs, biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta, listë të publikimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të të njejtave, Vendim nga zgjedhja e mëparshme në thirjen mësimore shkencore.

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me fondin e orëve dhe aktet e Universitetit.

Shuma e pages neto për pozicionet e shënuara është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimit mësimor të mësimdhënësit gjatë semestrit dhe thirjes mësimore shkencore në të cilën është bërë përzgjedhja dhe do të arrin prej 22.831 deri 34.446denarë.
Konkursi zgjat njëzet e një (21) ditë pune nga dita e shpalljes dhe zgjat deri më 30.01.2018. Fletparaqitjen me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet t'i dorëzojnë në hapësirat e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, rr. "12-ta Udarna Brigada" nr. 2-a/ Kati VI, me shënimin: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirjet mësimore shkencore edhe atë në:

**A.Fakultetin e ndërtimtarisedhearkitekturës**
**B. Fakultetin e shkencaveinformatike**
**C.Fakultetin e shkencaveteknike**
**Ç. Fakultetin e shkencavesociale**

Pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup.

**VËREJTJE:** Të punësuarit e Universitetit prej 02 deri me 08 Janar shfrytëzojnë pushim kolektiv.

Dokumentet jo të plota dhe ato që nuk do të dorëzohen në kohë nuk do të merren parasysh.

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup